



REPUBLIKA E SHQIPÉRISË  
PROKURORIA E PËRGJITHSHME  
PROKURORI I PËRGJITHSHËM

Nr.1756 prot.

Tiranë më,21.12.2021

**UDHËZIM I PËRGJITHSHËM**

Nr. 09, datë 21.12.2021

**PËR**  
**MARRËVESHJEN MBI KUSHTET PËR PRANIMIN E FAJËSISË DHE PËR**  
**CAKTIMIN E DËNIMIT**

Në mbështetje të nenit 148/b shkronja “b” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, neneve 38 pika 2 shkronjat “b” e “dh” dhe 46 pika 3 shkronja “c” të ligjit nr.97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neneve 24, 406/d deri 406/f në lidhje me nenet 37/a, 332/c, 332/dh, 290, 291, 328 e vijues të Kodit të Procedurës Penale, neneve 47, 36, 48, 49, 50, 52, 52/a, 52/b, 53, 54, 59, 63 e vijues të Kodit Penal, Rekomandimeve Prioritare “Për... luftën kundër kriminalitetit për vitin 2021” miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave<sup>1</sup> dhe jurispondencës së GJEDNJ<sup>2</sup>.

**UDHËZOJ:**

**KREU I**  
**DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

Neni 1  
Qëllimi

1. Ky udhëzim i përgjithshëm ka për qëllim shtimin e numrit të rasteve dhe unifikimin e veprimeve dhe akteve procedurale penale në zbatimin e institutit të marrëveshjes mbi kushtet për

<sup>1</sup> Shih, vendimin e Këshillit të Ministrave nr.326, datë 02.06.2021 “Për miratimin e rekomandimeve prioritare në luftën kundër kriminalitetit për vitin 2021” publikuar në Fletoren Zyrtare, Viti: 2021 – Numri: 93, me date 15 qershor 2021, drejtimi IV, rekomandimi 1, që parashikin: “Shtimin e numrit të rasteve të zbatimit të instrumenteve lehtësuese penale (marrëveshje...)..., me synim hetimin dhe gjykimin e çështjeve penale në një afat sa më të shpejtë, duke mbajtur në konsideratë kompleksitetin, rrezikshmërinë e veprës, si dhe duke ruajtur efikasitetin dhe cilësinë e hetimeve”;

<sup>2</sup> GJEDNJ-ja në çështjen Natsvlishili dhe Togonidze kundër Gjeorgjisë, nr.aplikimit 9043/05.,ka dhënë një interpretim ligjor të “gjykimit me marrëveshje” dhe gjithashtu një shpjegim mbi shtrirjen e përdorimit të tij nga Shtetet Anëtare të Këshillit të Evropës, ku Gjykata theksoi që: ‘Marrëveshja ndërmjet prokurorisë dhe mbrojtës - mundësia që një i akuzuar të marrë ulje të akuzave ose një ulje të dënimt të tij/saj në këmbim të pranimit të fajësisë ose një pohimi të mosdeklarimit - ishte një tipar i përbashkët i sistemeve të drejtësise penale Europiane. Fakti që një marrëveshje pranimi mund të arrrijë heqjen dorë nga të drejtat e caktuara procedurale nuk ishte në vetvete një problem sipas Nenit 6. Sidoqoftë, ishte e rëndësishme që: kjo heqje dorë ishte e qartë; ajo u shqërua me masa minimale mbrojtëse për të parandaluar abuzimin; dhe, ajo nuk binte ndesh me interesin publik.’

pranimin e fajësisë dhe për caktimin e dënimit të pandehurit në prokuroritë me juridikSION të përgjithshëm, rritjen e eficencës në veprimtarinë e sistemit të drejtësisë penale, shkurtimin e procedurave dhe kohëzgjatjes së procedimit, uljen e kostove të shpenzimeve procedurale penale, rritjen e efikasitetit të ndjekjes penale në rastet kur mundësohet zbulimi i veprave penale të tjera apo i autorëve të tjerë të kryerjes së tyre, konfiskimin e mjetit të kryerjes së veprës penale dhe produktet/pasuritë e ardhura nga veprimtaria kriminale dhe mundësimin e të pandehurve që në këmbim të pranimit të fajësisë të përfitojnë lehtësira në caktimin e llojit dhe/ose masës së dënimit, duke respektuar të drejtat e viktimës, shpërblimin e dëmit të shkaktuar viktimës/dëmturit.

## Neni 2 **Objekti**

1. Objekt i këtij udhëzimi të përgjithshëm janë:
  - a) Përcaktimi i mënyrave të kryerjes së marrëveshjes, kushteve/kritereve për fillimin e negociatave me propozim të pandehurit ose të prokurorit, pozicionit të viktimës/dëmtuarit, sigurimi i mbrojtjes të pandehurit dhe procedura në rastet e përfundimit të negociatave.
  - b) Përcaktimi i formës dhe përbajtjes së marrëveshjes, si dhe i mënyrës së llogaritjes për caktimin e dënimit.
  - c) Rastet kur mund të mos arrihet marrëveshja dhe tërheqja nga marrëveshja.
2. Në anekset 1 deri 6 bashkëlidhur këtij udhëzimi, trajtohen modele formularë tip për unifikimin e akteve procedurale penale në çështjet që prcedohet me marrëveshje mbi kushtet për pranimin e fajësisë dhe caktimin e dënimit.

## KREU II **MËNYRA E KRYERJES SË MARRËVESHJES**

### Neni 3 **Kushtet dhe kriteret për propozimin e marrëveshjes**

1. Prokurori, i pandehuri ose përfaqësuesi i tij i posaçëm<sup>3</sup>, mund të propozojnë arritjen e një marrëveshje mbi kushtet për pranimin e fajësisë, nga momenti i regjistrimit të emrit të personit që i atribuohet vepra penale derisa të mos ketë filluar shqyrtimi gjyqësor<sup>4</sup>, kur plotësohen kushtet për pranimin e fajësisë dhe për caktimin e dënimit.
2. Arritja e marrëveshjes lejohet vetëm për veprat penale, për të cilat parashikohet një dënim në maksimum deri në 7 vjet burgim.
3. Kufizimi i parashikuar në pikën 2 të këtij nenit nuk zbatohet në rastet e marrëveshjes me bashkëpunëtorin e drejtësisë, e cila rregullohet në mënyrë të posaçme me ligj<sup>5</sup>.

<sup>3</sup> Shih nenin 109 pika 1 të K.Pr.Penale.

<sup>4</sup> Koment: Marrëveshja mbi kushtet për pranimin e fajësisë mund të arrihet: -në fazën e hetimeve paraprake pas regjistrimit të emrit të pandehurit me aktin e njofimit të akuzës (*bazuar në nenit 34, 287 dhe 406/d pika 1 të K.Pr.Penale*), -në seancën paraprake (*bazuar në nenin 332/c pika 5 në lidhje me nenin 406/d dhe/ose 406/dh e vijues të K.Pr.Penal*) dhe -para fillimit të shqyrtimit gjyqësor në gjykimin e themelit kur palët (*prokurori, i pandehuri dhe avokati i tij*) kanë miratuar marrëveshjen përkatëse për ta paraqitur në atë gjykim (*bazuar në nenin 406/d në lidhje me nenit 354 pika 2, 356, 406/dh e vijues të K.Pr.Penale*);

<sup>5</sup> Shih, nenin 37/a "Bashkëpunimi me drejtësinë" e vijues të K.Pr.Penale, nenit 52/a "Përashtimi ose ulja e dënimit për bashkëpunëtorët e drejtësisë..." e vijues të K.Penal dhe ligjin nr.10173/2009 "Për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe bashkëpunëtorëve të drejtësisë".

4. Në bisedimet për arritjen e marrëveshjes është e detyrueshme prania e mbrojtësit të të pandehurit.

Neni 4  
**Propozimi i të pandehurit për marrëveshje**

1. Në rastet kur i pandehuri, ose mbrojtësi i zgjedhur prej tij, i propozon prokurorit të arrihet një marrëveshje ose ofron paraprakisht disa terma bashkëpunimi me drejtësinë për arritjen e marrëveshjes, prokurori i kërkon të pandehurit të paraqesë propozimin e tij me shkrim përmbrashjen e kushtit për pranimin e fajësisë dhe kërkuesat për caktimin e dënimit. Në rastet kur oferta e tij nuk mund të paraqitet në këtë formë, i pandehuri mund të shpjegojë gjatë marrjes në pyetje propozimin dhe kërkuesat e tij.

2. Prokurori në vlerësimin e propozimit bën kujdes, nëse ekzistojnë kushtet dhe kriteret ligjore dhe nëse propozimi për marrëveshje mundëson:

- a) shbangjen e diskutimeve ose zgjidhjen më të shpejtë të çështjeve të tjera që ka në ndjekje;
- b) shkurtimin e kohëzgjatjes së ndjekjes penale në hetimet paraprake ose të procedurës nga dërgimi i kërkuesës për gjykim deri në dënimin përfundimtar të pandehurit;
- c) uljen në mënyrë të konsiderueshme koston e shpenzimeve procedurale;
- ç) shbangjen e efekteve negative të dëshmisë publike në seancë gjyqësore të viktimit së dëmtuar ose dëshmitarëve të tjerë të ndjeshëm;
- d) aplikimin e dënimive alternative të dënitit me burgimit;
- dh) zbulimin e veprave penale të tjera ose të autorëve të tjerë të veprave penale.

3. Në vlerësimin e propozimit të pandehurit prokurori bën kujdes dhe merr kohën e nevojshme për dhënien e përgjigjes, përveç rasteve kur marrëveshja ose komunikimi është i pamundur, ose kur oferta e të pandehurit është në kundërshtim me ligjin. Në rastet e tjera, prokurori mund të përgjigjet se do të vlerësohet oferta dhe do të informojë të pandehurin për qëndrimin e tij brenda një kohe të arsyshme/caktuar.

4. Në rastet kur prokurori konsideron dhe vlerëson se nuk ka kushte/kritere ligjore për të lidhur marrëveshje, ose marrëveshja nuk është e dobishme në një rast të veçantë, ose nuk ka vend për negociata, prokurori gjatë marrjes në pyetje njofton të pandehurin dhe/ose mbrojtësin për mospranimin e marrëveshjes, ku pasqyron qëndrimin e tij, sipas modelit Aneksi 2 bashkëlidhur këtij udhëzimi.

5. Prokurori pasi njofton të pandehurin se është i gatshëm për të negociuar, mund t'i deklarojë kushtet e tij dhe të fillojë negociatat për ecurinë e mëtejshme të arritjes së marrëveshjes, duke vlerësuar dhe konsideruar:

- a) besimin e ndërsjellë, si një nga kushtet thelbësore të një marrëveshje mbi kushtet për pranimin e fajësisë, dhe prokurori, i cili ka ofruar negociata ose ka rënë dakord për marrëveshje, nuk duhet të ndryshojë qëndrimin e tij pa arsyё të përligjura;
- b) tërheqjen e paarsyeshme të prokurorit nga negociatat si qëndrim që mund të ndikojë në humbjen e besimit nga i pandehuri dhe mbrojtësi i tij, nëse mund të krijohet një mundësi tjetër për të hyrë në marrëveshje.

6. Prokurori deklaron gatishmërinë e tij për të biseduar/negocuar në varësi të vlerësimit të ofertave/sugjerimeve të pandehuri dhe mund të mos deklarojë menjëherë të gjitha kushtet e tij që në fillimin e negociatave, veçanërisht të mos ofrojë caktimin e dënitit më të ulët, atë nën të cilin nuk mund të shkojë më tej.

**7.** Përpara arrijes së marrëveshjes, prokurori vlerëson me kujdes, përbushjen e elementeve të marrëveshjes të parashikuar në nenin 406/d<sup>6</sup> të K.Pr.Penale, rrethanat e faktit dhe provat e administruara në procedimin penal, si dhe pasojat e mundshme të marrëveshjes.

Neni 5  
**Propozimi i prokurorit për marrëveshje**

1. Në rastet kur prokurori konstaton e vlerëson se, i pandehuri ka pranuar fajin, ka rënë dakord për një dënim të pranueshmë, kohëzgjatja e procedimit shkurtohet, dhe veçanërisht në rastin kur i pandehuri ka dhënë shpjegime se ndihet fajtor për të gjitha akuzat, si dhe se janë përbushur dhe rrethana/arsye të tjera të përcaktuara në ligj, ai e njofton të pandehurin dhe mbrojtësin se është i gatshëm të negocijoë kushtet ligjore, për të lidhur një marrëveshje për caktimin e llojit dhe masës së dënit, sipas modelit Aneksi 1 bashkëlidhur këtij udhëzimi.

2. Në rastet kur prokurori vlerëson rrethanat e faktit, ligjin e zbatueshmë dhe konstaton se nuk ka kushte/kritere ligjore për marrëveshje apo komunikimi nuk është i dobishëm në një rast të veçantë, prokurori gjatë marrjes në pyetje njofton të pandehurin dhe/ose mbrojtësin për mospranimin e marrëveshjes, ku pasqyron qëndrimin e tij, sipas modelit Aneksi 2 bashkëlidhur këtij udhëzimi.

Neni 6  
**Pozita e viktimës ose e trashëgimtarëve të tij**

1. Prokurori vlerëson nëse marrëveshja mbi kushtet për pranimin e fajësisë mund të jetë e papranueshme ose mund të ketë pasoja negative për viktimen<sup>7</sup> ose trashëgimtarët e tij, veçanërisht në rastet kur vepra penale është sensitive, apo ka sjellë si pasojë vdekjen e personit/ave, ose kur viktima është traumatizuar rëndë, për t'i garantuar viktimës ose trashëgimtarëve të saj respektimin e kërkesave të tyre lidhur me kryerjen e hetimeve<sup>8</sup>.

2. Kundërshtimi i viktimës<sup>9</sup> ose trashëgimtarëve të saj nuk e ndalon prokurorin për të lidhur marrëveshje kur ai vlerëson dhe konsideron se janë përbushur kushtet për marrëveshje për pranimin e fajësisë sipas nenit 406/d e vijues të K.Pr.Penale.

<sup>6</sup> Shih, nenin 406/d të K.Pr.Penale, krahas pikave 1 e 2 që trajtohen e neni 3 të këtij udhëzimi në pikat 3 e 5, parashikon: “3. Marrëveshja bëhet me shkrim dhe përban me paojë pavlefshmëri: a) përshtimin e qartë të faktit penal për të cilin akuzohet i pandehuri dhe cilësimin e tij juridik; b) deklarimin e pohimit të fajësisë nga ana e të pandehurit; c) llojin dhe masën e dënit penal kryesor, si dhe llojin e modalitetet e ekzekutimit të dënimive plotësuese, për të cilat palët kanë rënë dakord; c) disponimet për provat materiale dhe sendet që i përkasin veprës penale, si dhe për konfiskimin e mjeteve e produkteve të veprës penale, sipas nenit 36 të Kodit Penal; d) në rastin kur është legjitimuar paditësi civil, pëlqimin e tij me shkrim për masën e shpërbimit të dëmit nga i pandehuri; dh) shumëne shpenzimeve procedurale; e) nënshkrimet e palëvedhe të mbrojtësit.... 5. Marrëveshja me kusht për pranimin e pjesëmë të akuzave është e papranueshme.”

<sup>7</sup> Shih, nenin 58 “Të drejtat e viktimës së veprës penale” të K.Pr.Penale, i cili në pikën 1 shkronjat “a”, “d”, “g”, që parashikojnë: “1. Viktima e veprës penale ka të drejtë: a) të kërkojë ndjekjen penale të fajtorit; d) të kërkojë në çdo kohë informacion për gjendjen e procedimit, si dhe të njihet me aktet e provat...; g) të kërkojë shpërbimin e dëmit dhe të pranohet si paditës civil në procesin penal;”

<sup>8</sup> Shih Dimitrova dhe të tjera kundër Bullgarisë, nr. 44862/04, 27 Janar 2011, ku u konstatua se autoritetet nuk arritën të merrnin parasysh prova të rëndësishme të mbledhura gjatë hetimit të tyre për një vdekje, si dhe ishin përgjegjës për një numër dështimesh të tjera hetimore. Për më tepër, i afërm i viktimës nuk ishte në gjendje të merrte pjesë në mënyrë efektive në hetimin për vdekjen e tij. Si përfundim, Gjykata Europiane nxori përfundimin që ka patur një shkelje të Nenit 2 të të Protokollit Nr. 7 të Konventës Europiane..

<sup>9</sup> Shih vendimin e GJEDNJ X dhe Y kundër Gjeorgjisë (dhjetor), nr. 5358/14, 9 shtator 2014 ‘Gjykata Evropiane, deri më tanë, nuk e ka konsideruar nga këndvështrimi i viktimës pajtueshmërinë me Konventën Evropiane të një

3. Në raste kur viktima ka ngritur padi civile në procesin penal kundër të pandehurit për të kerkuar kthimin e pasurisë ose shpérblimin e dëmit, viktima<sup>10</sup> në cilësinë e paditësit civil në procesin penal nuk mund të kundërshtojë ndërprerjen e negocimit për marrëveshje apo gjykimit me marrëveshje, nëse akoma është e mundur që ai/ajo të fillojnë procedurat e përshtatshme në gjykatat civile.

Neni 7

### Kushtet për fillimin dhe ecurinë e negociatave

1. Para se prokurori të japë një përgjigje pozitive për kërkesën e të pandehurit për të hyrë në marrëveshje, ai vlereson ekzistencën e rrethanave, kushteve/kritereve ligjore dhe arsyet të cilat i mundësojnë të komunikojë me të pandehurin për lidhjen e marrëveshjes mbi kushtet për pranimin e fajësisë.

2. Gjatë procesit të negociatave dhe komunikimit, lidhur me propozimet e prokurorit, ose propozimet e të pandehurit apo mbrojtësit të tij, të tregohet kujdes dhe vlerësohen pikat kyçë të propozimit të pandehurit, dhe veçanërisht ato që prokurori i ofron të pandehurit.

3. Në raste veçanërisht të vështira dhe komplekse, negotiatat e të cilave janë kryer paraprakisht për arsyet se ka ekzistuar mundësia për të rënë dakord me të pandehurit, i cili shprehet për të bashkëpunuar me drejtësinë<sup>11</sup> për zbulimin e veprave penale të tjera ose të autorëve të tjerë, të bëhet kujdes në vlerësimin e kushteve dhe kritereve ligjore të bashkëpunimit me drejtësisë sipas ligjit<sup>12</sup>.

Neni 8

### Sigurimi i mbrojtësit të pandehurit

1. Në bisedimet për arritjen e marrëveshjes prania e mbrojtësit të të pandehurit është e detyrueshme.

a) Në rastet kur i pandehuri i është përgjigjur pozitivisht ofertës së prokurorit për të hyrë në negociata, prokurori fillimisht sigurohet nëse i pandehuri ka një mbrojtës të zgjedhur.

b) Në rastet kur i pandehuri nuk ka një mbrojtës, vlerësohet dhe udhëzohet nga prokurori të sigurojë një mbrojtës që duhet të marrë pjesë gjatë negociatave për marrëveshje.

c) Në rastet kur prokurori vlereson se i pandehuri nuk ka një mbrojtës, dhe për shkak të mungesës së mjeteve financiare ai kërkon mbrojtje, ose ka mbetur pa mbrojtës, apo kur negotiatat janë në interes të veçantë të procedurave për të zbuluar krime të tjera ose autorë të

---

*marrëveshjeje të përfunduar me një autor të veprave të caktuara kur qëllimi është të niset çështje kundër të tjerëve të përfshirë në kryerjen e saj.*

<sup>10</sup>Shih Vendimin e GJEDNJ-Nikolov kundër Bullgarisë (dec.), Nr. 39672/03, 28 Shtator 2010, "...Edhe kur asnje e drejtë në bazë të Konventës Evropiane nuk preket nga një vepër, përfundimi i një marrëveshjeje nuk duhet të ketë efektiv e parandalimit të viktimës nga ndjekja e ndonjë pretendimi civil që mund të lindë nga sjellja e kundërshtuar. Megjithatë, një viktimë që i është bashkuar procedurës penale si palë civile nuk mund të kundërshtojë ndërprerjen e gjykimit nëpërmjet përfundimit të marrëveshjes së pranimit të fajësisë, nëse akoma është e mundur që ai ose ajo të fillojnë procedurat e përshtatshme në gjykatat civile. Gjykata Evropiane ishte e bindur që, duke marrë parasysh mënyrën në të cilën u zhvillua procesi penal, nuk kishte ndodhur ndonjë paragjykim serioz për të drejtën e kërkuesit të kërkonte kompensim dhe, duke pasur parasysh mjetin alternativ menjëherë të disponueshmë për të, nuk mund të thuhej se kufizimi dëmtonte thelbën e "së drejtës së tij në gjykatë" ose ishte disproporcionale për qëllimet e Nenit 6 (I) të Konventës Evropiane.

<sup>11</sup> Shih nenin 37/b "Përbajtja e marrëveshjes" të K.Pr.Penale, i cili në pikën 1 shkronja "d" parashikon: "1. Marrëveshja me bashkëpunëtorin e drejtësisë përmban: d) të drejtën e bashkëpunëtorit për të kerkuar lidhjen e një marrëveshjeje me prokurorin për pranimin e fajësisë dhe caktimin e dënimit, sipas neneve 406/d e vijues të këtij Kodi."

<sup>12</sup> Shih nenet 37, 37/a e vijues të K.Pr.Penale.

tjerë, dhe jo vetëm, prokurori i cakton të pandehurit mbrojtës, sipas ligjit<sup>13</sup>, i cili do të përfaqësojë interesat e të pandehurit gjatë marrëveshjes.

#### Neni 9

#### **Mënyra e kryerjes së marrëveshjes dhe roli i drejtuesit të prokurorisë**

1. Në mungesë të parashikimit në ligj se si prokurori do të negociojë me të pandehurin, rekomandohet që prokurori të bëj kujdes që të sigurojë ardhjen e të pandehurit dhe mbrojtësit të tij në ambientet e prokurorisë, ndërsa vetëm kur e kërkojnë rrethana të veçanta (paraburgimi, etj.), negociatat mund të zhvillohen jashtë zyrës së prokurorisë, duke shmangur zhvillimin e bisedimeve në mjetë publike ose në ambjente të papërshtashme.

2. Në të gjitha rastet kur prokurori për çështjet në ndjekje kërkon të krijojë kushte për zbulimin e veprave penale të tjera ose të autorëve të tjerë të veprave penale, dhe për këtë arsyе lidhet një marrëveshje me të pandehurin sipas ligjit, ai bën kujdes të vlerësojë dhe vendosë një dënim brenda kufirit më të ulët/minimal të përcaktuar për atë vepër penale<sup>14</sup> dhe/ose sipas ligjit të posaçëm<sup>15</sup>.

3. Drejtuesi i prokurorisë<sup>16</sup>, në kuadrin e zbatimit të politikave institucionale të prokurorisë dhe qëllimit të këtij udhëzimi, në zbatimin e kompetencave në lidhje me ushtrimin e ndjekjes penale sipas ligjit<sup>17</sup>, në rastet kur bazuar në gjendjen e akteve referuese vlerëson se mund të procedohet me marrëveshja mbi kushtet për pranimin e fajësisë dhe caktimin e dënimit, nxjerr udhëzim jo të detyrueshëm me shkrim<sup>18</sup> për çështjen konkrete dhe prokurorin përkatës, ku veç të tjerash mund të udhëzoj për të proceduar me marrëveshje mbi kushtet për pranimin e fajësisë dhe caktimin e dënimit.

4. Mbi kërkesën e drejtuesit për informacion për ecurinë e procedimit<sup>19</sup> prokurori informon drejtuesin e prokurorisë për ecurinë dhe përbajtjen e marrëveshjes.

#### Neni 10

#### **Përfundimi i negociatave**

Në rastet kur gjatë negotiatave i pandehuri tërheq propozimin e tij për negocim, ose i pandehuri nuk i pranon kushtet e ofruara nga prokurori dhe përfundojnë negotiatat, prokurori i kërkon të pandehurit të paraqesë me shkrim qëndrimin e tij në lidhje me tërheqjen nga propozimi për marrëveshje. Në rast të mosparaqitjes të qëndrimit të tij në këtë formë, i pandehuri mund të shpjegojë gjatë marrjes në pyetje tërheqjen nga propozimi për marrëveshje.

#### Neni 11

<sup>13</sup> Shih, nenin 49 në lidhje me nenin 406/d pika 2 të K.Pr.Penale;

<sup>14</sup> Shih nenin 37/b “Përbajtja e marrëveshjes” e K.Pr.Penale, i cili në pikën 1 shkronjat “d” e “dh”, parashikon: “*I.Marrëveshja për bashkëpunëtorin e drejtësisë, përbajtja: d) të drejtien e bashkëpunëtorit për të kërkuar lidhjen e një marrëveshje me prokurorin për pranimin e fajësisë dhe caktimin e dënimit, sipas neneve 406/d e vijues të këtij Kodi; dh) detyrimin e prokurorit që t'i kërkajë gjykatës uljen e masës së dënimit ose përjashtimin e tij nga dënim, në përpjestim të drejtë me shkallën e kontributit të tij në bashkëpunimin me drejtësinë; ”* në lidhje me ligjin nr.10173/2009 “Për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe bashkëpunëtorëve të drejtësisë” dhe nenin 52/a “*Përjashtimi ose ulja e dënimit për bashkëpunëtorët e drejtësisë...*” e vijues të K.Penal.

<sup>15</sup> Shih nenet 47, 48, 49, 50 në lidhje me nenet 51, 52, 52/a, 52/b, 53, 53/a, 59, 63 e vijues të K.Penal.

<sup>16</sup> Shih, nenin 48 “Udhëzimet jo të detyrueshme për çështje konkrete”, pika 1 shkronja “c”.

<sup>17</sup> Shih nenin 43 në lidhje me nenin 48 të ligjit nr.76/2016;

<sup>18</sup> Shih, nenin 48, pikat 3, 4 e 5 të ligjit nr.97/2016.

<sup>19</sup> Shih, nenin 43 shkronja “b” e vijues të ligjit nr.97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”;

## Térheqja nga marrëveshja

1. I pandehuri dhe prokurori mund të tèrhiqen nga marrëveshja pas nënshkrimit, në fazën e hetimeve paraprake ose gjatë shqyrtimit në gjykatë.

2. Në rast kur i pandehuri tèrhiqet nga marrëveshja, aktet administrohen në fashikullin e prokurorit që do të shqyrtohen dhe vlerësohen nga gjyqtari i seancës paraprake. Në këto raste, prokurori nuk mund të përdorë kundër tij<sup>20</sup> aktet e përfshira në marrëveshjen mbi kushtet për pranimin e fajësisë dhe caktimin e dënimit.

3. Prokurori bën kujdes që qëndrimet e tij në secilin prej rasteve individuale të jenë të tilla që të mos vënë në dyshim marrëveshjen e arritur, me kusht që pala tjetër t'i përbahet marrëveshjes që është dakordësuar.

4. Prokurori mund të tèrhiqet nga marrëveshja për arsyen e që gjyqtari i seancës paraprake ka qëndrimet e tij në secilin prej rasteve individuale të jenë të tilla që të mos vënë në dyshim marrëveshjen e arritur, me kusht që pala tjetër t'i përbahet marrëveshjes që është dakordësuar.

a) kur i pandehuri nuk i përbush disa nga dispozitat e marrëveshjes që ishin vendimtare për pranimin e marrëveshjes<sup>21</sup>, sipas modelit Aneksi 3 bashkëlidhur këtij udhëzimi.

## KREU III FORMA DHE PËRMBAJTJA E MARRËVESHJES

Neni 12

### Forma e marrëveshjes

1. Forma me shkrim e marrëveshjes mbi kushtet për pranimin e fajësisë midis palëve dhe forma me shkrim e kërkesës drejtuar gjykatës për pranimin e marrëveshjes midis palëve të arritur gjatë fazës së gjykimit, të nënshkruara nga palët, janë akte procedurale penale që unifikojnë formën dhe përmbajtjen e paraqitjes së marrëveshjes dhe deklarimet përkatëse, sipas modeleve Aneksi 4 dhe Aneksi 6 bashkëlidhur këtij udhëzimi, që prokurori vlerëson dhe kujdeset për plotësimin e saktë dhe të qartë të tyre sipas rrëthanave, kushteve/kritereve në çështjen konkrete, si dhe për nënshkrimin e secilit prej tyre/palëve.

2. Në aspektin formal marrëveshja ka elementët e përshkruar në pikën 3 shkronjat “a” deri “e” të nenit 406/d të K.Pr.Penale, me pasojë pavlefshmërinë e marrëveshjes, nëse i mungon secili element i saj.

Neni 13

### Përmbajtja e marrëveshjes

1. Në përmbajtjen e marrëveshjes prokurori analizon dhe vlerëson secilin element të listuar në shkronjat “a” deri “e” të pikën 3, neni 406/d të K.Pr.Penale, për të pasqyruar:

a) përshkrimin e qartë të faktit penal për të cilin akuzohet i pandehuri dhe cilësimin e drejtë juridik të tij, ku përshkrimi i fakteve dhe cilësimi juridik i veprës/veprave penale, për të cilat i pandehuri pranon fajësinë në marrëveshje dhe në deklaratë, duhet të jenë të përzasura me përshkrimin faktik dhe ligjor të plotë dhe të qartë, si dhe në këtë rubrikë kujdeset që të

<sup>20</sup> Shih, nenin 406/ë të K.Pr.Penale, i cili në pikën 3 parashikon: “3.Deklarimet e të pandehurit gjatë seancës nuk mund të përdoren kundra tij”.

<sup>21</sup> Shih, po aty nenin 406/ë shkronjat “c”, “d”, “dh” e “e”;

përshkruhen provat në të cilat mbështetet fakti penal në ngarkim të pandehurit dhe analiza e elementeve të figurës së veprës/ve penale përkatëse.

b) *deklarimin e pohimit të fajësisë nga ana e të pandehurit*, ku pjesët individuale të deklarimit të pandehurit nuk mund të jenë të ndryshme me ato në marrëveshje, si dhe në deklarim mund të përfshkruhet se i pandehuri ka marrë njoftim për akuzën, se është konsultuar me mbrojtësin për mbrojtjen e tij dhe se është i gatshëm të nënshkruajë deklarimin e pranimit të plotë të fajit për veprën penale të përshkruar në mënyrë faktike dhe të ligjshme në Marrëveshje, si dhe se i pandehuri deklaron se më parë ishte paralajmëruar nga mbrojtësi për pasojat e nënshkrimit të kësaj deklarate.

Kur i pandehuri është në kushtet e bashkëpunimit me drejtësinë për zbulimin e veprave penale të tjera ose autorëve të tjerë të veprave penale, krahas sa më sipër, mund të përshkruhet edhe se ai deklaron se do të dëshmojë si dëshmitar në procedurën penale përkatëse, për veprën penale apo autorët e tjerë të përmendur sipas ligjit<sup>22</sup>, e cila është duke u zhvilluar para gjykatës, dhe se ai ka deklaruar prokurorit pranimin e fajësisë.

c) *llojin dhe masën e dënimit penal kryesor, si dhe llojin e modalitetet e ekzekutimit të dënimive plotësuese, për të cilat palët kanë rënë dakord*, ku mund të përshkruhet se i pandehuri deklaron se është i vetëdijshëm se vepër/t penale për të cilën është ngriturakuza ndaj tij mund të dënohet me burgim më të lartë (deri “x” vjet) dhe se prokuroria e konsideron se dënim i duhur për këtë vepër penale do të ishte një dënim me burg më të ashpër (të paktën “y” vjet), dhe se është i vetëdijshëm se prokuroria pajtohet të vendosë një dënim më të ulët (në “z” vjet) nga sa do të kërkohej nëse do të ndiqej procedura e zakonshme e gjykimit.

c) *disponimet për provat materiale dhe sendet që i përkasin veprës penale, si dhe për konfiskimin e mjeteve e produkteve të veprës penale, sipas nenit 36 të Kodit Penal*, ku mund të përshkruhet se i pandehuri deklaron se është dakord për disponimet për provat materiale dhe sendet që i përkasin veprës penale, si dhe për konfiskimin e të gjitha mjeteve e produkteve të veprës penale dhe pasurisë përkatëse.

d) *në rastin kur është legjitimuar paditësi civil, pëlqimin e tij me shkrim për masën e shpërbimit të dëmit nga i pandehuri*, ku mund të përshkruhet se i pandehuri deklaron se e pranon kompensimin e dëmit pasuror dhe merr përsipër ta përbushë masën e shpërbimit të dëmit në interes të viktims/dëmtuarit/paditësit civil.

dh) *shumën e shpenzimeve procedurale*, ku mund të përshkruhet se i pandehuri do të paguaj gjithë shpenzimet procedurale në shumën përkatëse, si dhe se është i vetëdijshëm se këto shpenzime nuk përfshijnë kostot e mbrojtësit të zgjedhur prej tij;

e) *nënshkrimet e palëve dhe të mbrojtësit*, ku akti i marrëveshjes nënshkruhet rregullisht nga prokurori, i pandehuri dhe mbrojtësi i tij.

2. Marrëveshja me shkrim formulohet pasi të jetë përgatitur dhe njoftuarakuza të pandehurit, në mënyrë që të mos ketë dallime të rendësishme në përshkrimin e faktit penal dhe cilësimit ligjor të veprës penale që është objekt i marrëveshjes në kërkesën për gjykim me të dhënat në marrëveshjen me shkrim dhe në deklarimin e të pandehurit.

3. Marrëveshja me shkrim me bashkëpunëtorin e drejtësisë mund të përbajë disa dispozita që nuk përfshihen në deklarimin e të pandehurit, të cilat rregullojnë detyrimet e ndërsjella ndërmjet prokurorit dhe të pandehurit sipas ligjit<sup>23</sup>.

#### KREU IV MËNYRA E LLOGARITJES SË DËNIMIT ME MARRËVESHJE

<sup>22</sup> Shih nenet 37/a, 37/b e vijues të K.Pr.Penale.

<sup>23</sup> Shih, nenet 37/a, 37/b e vijues të K.Pr.Penale;

Neni 14  
**Mënyra e përgjithshme e caktimit të dënimit**

1. Prokurori në kërkesën për caktimin e llojit dhe masës së dënimit dhe në zbatim të këtij udhëzimi, i referohet mënyrës së përgjithshme të caktimit të dënimit sipas ligjit<sup>24</sup>:

a) caktimi i dënimit referuar dispozitave të pjesës së përgjithshme të Kodit Penal dhe kufijtë e dënimeve të parashikuara për secilën vepër penale;

b) caktimin e dënimit ndaj personit, referuar rrezikshmërisë së veprës penale, rrezikshmërisë së autorit të veprës penale, shkallën e fajit, si dhe rrethanat lehtësuese dhe ato rënduese.

Neni 15  
**Rrethana të veçanta në caktimin e dënimit me marrëveshje**

1. Rrethanat e veçanta që prokurori vlerëson për uljen e dënimit të pandehurit në marrëveshje mbi kushtet e caktimit të dënimit janë:

a) marrëveshja shkurton kohëzgjatjen e procedurave ose shhang dëshminë publike të viktims së démtuar ose dëshmitarëve të tjerë në seancë gjyqësore, rrethana lehtësuese<sup>25</sup> që prokurori i trajton në marrëveshje dhe i vlerëson për caktimin e një dënim mi të ulët ndaj të pandehurit;

b) marrëveshja lejon zbulimin e veprave penale të tjera ose autorëve të tjerë të veprave penale në interes publik, rrethana lehtësuese<sup>26</sup> që prokurori i trajton në marrëveshje dhe i vlerëson në caktimin e një dënim mi të ulët ndaj të pandehurit.

2. Prokurori bën kujdes dhe vlerëson caktimin e llojit dhe masës së dënimit të pranueshëm në marrëveshje me të pandehurin mbi kushtet e caktimit të dënimit në rastet kur janë kryer krime që viktimat janë traumatizuar rëndë ose kanë humbur jetën e tyre, ose të mitur.

3. Llogaritura e dënimit penal të pranueshëm për prokurorin në një rast të veçantë varet, ndër të tjera, nga rrethanat e veçanta, si ato në pikën 2 të këtij nenit, dhe arsyet ligjore të tjera për lidhjen e marrëveshjes midis prokurorit dhe të pandehurit.

Neni 16  
**Kriteret për llogaritjen e dënimit të caktuar me marrëveshje**

1. Në llogaritjen e dënimit penal të përshtatshëm të caktuar për të pandehurin me marrëveshje prokurori respekton dhe vlerëson kriteret, në raport me:

a) veprën penale të kryer në përpjesëtim të drejtë me politikën e dënimit për këtë vepër penale të veçantë dhe elementët e rrezikshmërisë së saj, të autorit të saj, shkallën e fajit, rrethanat lehtësuese dhe rënduese, rrethanat e veçanta dhe arsyet ligjore për lidhjen e marrëveshjes që ndikojnë në uljen e dënimit penal në secilin rast të veçantë.

b) personalitetin e të pandehurit, rrethanat e kryerjes së veprës penale prej tij, marrëdhëniet me viktimin, rrethanat e veçanta dhe arsyet ligjore për lidhjen e marrëveshjes që ndikojnë në uljen e dënimit penal në secilin rast të veçantë.

<sup>24</sup> Shih, nenin 47 "Mënyra e caktimit të dënimit" në lidhje me nenet 48, 49, 50, 51, 52, 52/a, 52/b, 53, 53/a, 55, 59, 63, 36 e vijues të K.Penal;

<sup>25</sup> Shih, nenet 48 shkronjat "ç", "d", "e" e 49 e vijues të K.Penal;

<sup>26</sup> Shin po aty nenet 48 shkronjat "ç", "d", "e" e 49 e vijues;

2. Në llogaritjen e dënimit të caktuar me marrëveshje lloji dhe masa më e ulët e dënimit penal e llogaritur për të pandehurin nuk duhet të jetë më pak e favorshme se dënimini penal i pritshëm që prokurori mund të zbatonte në procedurën e zakonshme për këtë të pandehur.

3. Në vlerësimin e dënimit penal të pritshëm që mund të arrihet në procedurën e zakonshme, prokurori kujdeset të fillojë vlerësimin nga dënimet e zakonshme të vendosura për një veprë penale të veçantë në fushën përkatëse në prokurorinë e rrëthit gjyqësore që ai ushtron funksionin, dhe jo vetëm, ashtu dhe të vlerësojë veçanërisht personalitetin e të pandehurit, si dhe të gjitha rrëthanat lehtësuese dhe rënduese që ekzistojnë në rastin e caktimit të llojit dhe masës së dënimit me marrëveshje.

3. Në rastet kur politika e dënimit për një veprë penale të caktuar nga prokurori në atë prokurori të rrëthit gjyqësore është më e lartë se mesatarja, prokurori vlerëson me kujdes këto rrëthana si mundësi më të mëdha për të negociuar caktimin me marrëveshje të një lloji e mase dënimini penal të përshtatshëm.

4. Në mënyrën e caktimit të dënimit me marrëveshje, gjithashtu prokurori vlerëson me kujdes:

a) në çdo rast, dënimini penal i dakordësuar nuk mund të jetë nën kufirin e parashikuar me ligj të dënimit që mund të caktohet për atë veprë penale;

b) në nenin 406/e, pika 2, shkronja "d" të K.Pr.Penale parashikohet se kur gjykata vendos miratimin e marrëveshjes dhe deklaron fajtor të pandehurin, përvèç caktimit të dënimit, vendos dhe disponime të tjera, sipas përbajtjes së marrëveshjes, ku sipas nenit 406/d pika 3 shkronja "ç" përfshihet dhe konfiskimi e mjeteve dhe produkteve të veprës penale, në përputhje me të cilën:

- në rastin kur është legjitimuar paditësi civil, i kërkohet pëlqimi i tij në marrëveshje për masën e shpërblimit të dëmit viktims/dëmtuarit/paditësit civil<sup>27</sup> si dhe;

- kur negociohet marrëveshja me të pandehur për vepra penale nëpërmjet të cilave janë përfituar prova materiale, sende që i përkasin veprës penale dhe/ose produkte të veprës penale, lidhur me llojet/masat e dënimit plotësues<sup>28</sup>, të pandehurit i kërkohet qëndrimi i tij për dorëzimin e provave apo sendeve materiale (drogë, armë e sende tjera kriminale) dhe produktet apo pasuritë e përfshira nga veprimtaria kriminale ose vlera ekuivalente e tyre, të cilat duhet të konfiskohen.

c) Në të gjitha rastet, marrëveshja duhet të specifikojë llojin dhe masën e dënimini penal që prokurori e vlerëson dhe e konsideron të përshtatshme në raport me veprën penale dhe personalitetin e të pandehurit. Kjo duhet të bëhet jo vetëm për të informuar të pandehurin se cili është lloji dhe masa e dënimit penal që prokurori do ta konsideronte të përshtatshme nëse nuk ka marrëveshje, por edhe për të dokumentuar vlerësimin lidhur me propozimin e dënimit penal ndaj të pandehurit.

## KREU V

### NJOHJA, SHKELJET DISIPLINORE, ZBATIMI, HYRJA NË FUQI DHE PUBLIKIMI

Neni 17

**Njohja**

<sup>27</sup> Shih K.Pr.Penale, nenin 406/d, pika 3, shkronja "d" që parashikon: "3. Marrëveshja bëhet me shkrim dhe përmban me pasojë pavlefshmërie: d) në rastet kur është legjitimuar paditësi civil, pëlqimin e tij me shkrim për masën e shpërblimit të dëmit nga i pandehuri."

<sup>28</sup> Shih po aty nenin 406/d, pika 3, shkronja "ç" që parashikon: "3. Marrëveshja bëhet me shkrim dhe përmban me pasojë pavlefshmërie: ç) disponimet për provat materiale dhe sendet që i përkasin veprës penale. Si dhe për konfiskimin e mjeteve e produkteve të veprës penale, sipas nenit 36 të K.Penal."

Me këtë udhëzim të përgjithshëm të njihen gjithë prokurorët dhe oficerët e policisë gjyqësore të seksioneve në prokuroritë me juridikcion të përgjithshëm dhe oficerët e policisë gjyqësore të shërbimeve në strukturat hetimore përkatëse në Policinë e Shtetit.

Neni 18

### **Shkeljet dhe verifikimet disiplinore**

Shkelja e dispozitave ligjore referuese në këtë udhëzim të përgjithshëm dhe/ose mosbatimi i normimeve të përcaktuara në këtë udhëzim, mund të përbëjnë, shkelje disiplinore sipas ligjit<sup>29</sup> dhe/ose shkak për nisjen e verifikimeve nga sektori i monitorimit në Prokurorinë e Përgjithshme ndaj prokurorit dhe/ose drejtuesit në prokuroritë me juridikcion të përgjithshëm, sipas ligjit

Neni 19

### **Zbatimi dhe mbikëqyrja**

1. Ky udhëzim është i detyrueshëm për zbatim nga prokurorët pranë prokurorive me juridikcion të përgjithshëm, oficerët e policisë gjyqësore të seksioneve në prokurori dhe të shërbimeve në strukturat hetimore përkatëse në Policinë e Shtetit, si dhe koordinatorët e viktimave në prokuroritë e juridikcionit të përgjithshëm.

2. Me mbikëqyrjen e zbatimin e këtij udhëzimi të përgjithshëm ngarkohen drejtuesit e prokurorive të juridikcionit të përgjithshëm dhe Sektori i Monitorimeve në Prokurorinë e Përgjithshme.

3. Drejtuesit e prokurorive mund të nxjerrin udhëzime të përgjithshme për lehtësimin e zbatimit të këtij udhëzimi të përgjithshëm.<sup>30</sup>

Neni 20

### **Hyrja në fuqi dhe publikimi**

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe të publikohet në faqen e internetit të Prokurorisë Përgjithshme.

## **PROKURORI I PËRGJITHSHËM**



<sup>29</sup> Shih, nenin 148/d paragrafi 1 i Kushtetutës dhe nenet 101 pika 1 shkronja "a" "b" dhe 102 pika 1 shkronjat "c" "ç", "d" "dh", "e", "g", "i", "j", "nj"; pika 2 shkronjat "a", "b", "c", "ç", "d", "dh" të ligjit nr.96/2016, i ndryshuar me ligjin nr.48/2019 dhe nen 89 e vijues të ligjit nr.97/2016 "Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë".

<sup>30</sup> Shih, nen 46 pika 4 i ligjit nr.97/2016..